



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:071753

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05837982

KE.nr. 180/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Krasniqi Group” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811334929 dhe me seli në Malishevë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Albert S. Kryeziu nga Malisheva, kundër të paditurës GP-OIL Sh.P.K., me seli në Malishevë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, jashtë seancës, me datë 20.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e ushtruar nga paditësi “Krasniqi Group” Sh.P.K., me seli në Malishevë, kundër të paditurës GP-OIL Sh.P.K., me seli në Malishevë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi “Krasniqi Group” Sh.P.K., përmes të autorizuarit të tij, me datë 04.03.2024 ka paraqitur padi kundër të paditurit GP-OIL Sh.P.K., me seli në Malishevë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me parashtrësën e datës 19.06.2024 e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar me datë 04.03.2024 për arsye se me të paditurit kanë arritur një pajtim jashtëgjyqësor.

Andaj Gjykata, duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:071753
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05837982

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 180/24, datë 20.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.